

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

**TEMA: PRINCIPET, OBJEKTIVAT DHE FILOZOFIJA E
TURIZMIT**

(PUNIM DIPLOME – MASTER)

Kandidati:

Shukri Morina

Mentori:

Prof.dr. Bujar Turjaka

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

1. **HYRJE**
2. **QELLIMI I PUNIMIT**
3. **METODAT E PUNES**
4. **PRINCIPET, OBJEKTIVAT DHE FILOZOFIJA E TURIZMIT**
5. **FILOZOFIJA E TURIZMIT**
6. **LLOJET E TURIZMIT**
7. **PERFUNDIMI**
8. **ABSTRACT**
9. **LITERATURA**

1. HYRJE

Turizmi në botë por edhe te ne është zhvilluar në veprimtarin e rëndësishme ekonomike, me ndikim të dukshëm në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror-ekonomik të vendit. Pos funksionit themelor ekonomik të turizmit, rol me rëndësi kanë edhe disa funksione shoqërore siq janë: funksionet shëndetësore, sportive-rekreative, kulturore, arsimore, sociale dhe politike. Rëndësia e turizmit si fenomen socio-hapsinor e ekonomik dhe perspektiva e tij, është vështirë të shiqohet edhe pas një shekulli të qëndrimit të tij. Megjithatë, sigurisht që turizmi sot kryen funksion shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të secilit vend, qoftë ajo receptive apo iniciale. Si “ndarje e veçantë shoqërore e punës” turizmi, pos tjerash, potencon udhëzim dhe lidhshmëri ndërmjet veti të tërësive të ndryshme hapsinore ekonomiko-gjeografike. Turizmi është mundësi e shfrytëzimit të të mirave joproduktive, sepse nëpërmjet turizmit disa hapsira atraktive fitojnë vlerën e pasurive natyrore, ndërsa me këtë edhe vlerën e tyre ekonomike. Mu për këtë shumë vende shohin në turizëm shansin dhe mundësin e kyqjes së shpejtë dhe me sukses në ndarjen ndërkombëtare të punës. Turizmi ka efekte të rëndësishme me përmasa ndërkombëtare, në përmirësimin e bilansit të të ardhurave të një vendi. Turizmi gjithashtu direkt ose indirekt ndikon në disa degë ekonomike (në komunikacion, tregëti, industri, bujqësi, pylltari). Klientiteti turistik kryesisht bëhet për shkak të nevojës për pushim dhe kultivim.

Fenomeni i turizmit dhe fillimi i tij historik vështirë se mund të definohet në pikpamje kohore. Ekspertët dhe shkenctarët turistik nuk mund të pajtohen në përcaktimin e kohës së krijimit të turizmit, si dhe zhvillimit historik të kësaj dukurie shoqërore. Disa mendojnë se turizmi është e arritur bashkëkohore e qarkullimit (lëvizjes, simulimit) të banorëve dhe se bën pjesë në radhën e dukurive (paraqitjeve) të reja shoqërore-ekonomike të zhvillimit ekonomik e shoqëror të kohës së re dhe se nuk mund të flitet për “historin e turizmit”.

Të tjerët mendojnë se turizmi ka histori të gjatë dhe se është krijuar në kohën antike. Sipas mendimeve të shumicës, pa marrë parasyshë se si quhet kjo dukuri në disa epoka kohore, është me rëndësi të vërtetohet se a kanë vepruar në të faktorë të cilët na bëjnë me dije egzistimin e kësaj dukurie shoqërore; ato janë: faktorë lëvizës.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij punimi do të jetë që të vë në pah rolin e përmbajtjeve, modeleve dhe objekteve që përdoren në funksion të zhvillimit të turizmit.

Nevoja e njeriut bashkëkohor për aktivitete rekreative është e pashmangshme për jetën e sotme si dhe komoditetin që ka ofru avansimi i lartë i teknologjisë.

Nga mungesa e aktiviteteve fizike janë të rrezikuar sidomos të gjithë njerëzit që punojnë në ambiente të mbyllura, në zyra, punë statike dhe monotone, punëtorë në prodhim, të cilët kanë nevojë për ripërtëritjen e aftësive të tyre punuese pas punës së lodhshme fizike. Përmes këtij punimi do të shpjegohet rëndësia e lëvizjes, rekreacionit, si dhe do të propozohen programe të caktuara për aktivitete të organizuara rekreative të cilat janë në funksion të zhvillimit të turizmit.

Në Kosovë punime dhe hulumtime nga lëmi i turizmit po thuajse nuk ka fare qoftë në nivelin profesional qoftë në atë shkencor, andaj përpjekjet e mia për ta realizuar këtë punim do të mbështeten në literaturën e huaj. Kjo natyrisht do ta vështirëson punën time, por do të përpiqem që të përdor literaturë të duhur për ta realizuar qëllimin e punimit. Do të përqendrohem kryesisht në aktivitetet rekreative kryesore që janë të domosdoshme për mirëqenien e njeriut bashkohor e në të njejtën kohe ndikimi i tyre në organizmin e njeriut si dhe e pa shmangshme është edhe ndikimi direkt në cilesinë e turizmit.

3. METODAT E PUNËS

Përveç përshkrimit të rolit dhe rëndësisë së aktiviteteve rekreative do të përdor edhe programe të ndryshme të aktiviteteve rekreative të cilat më së miri do t'i përshtateshin natyrës së punës, përkatësisht do të ndikonin në zhvillimin e turizmit me çka do të rritej ekonomia e atij vendi.


Pra, metodat kryesore që do të përdoren janë:

- Metoda e mbledhjes së materialeve të shkruara
- Metoda e përshkrimit
- Metoda e analizës së të dhënave
- Metoda empirike

4. PRINCIPET, OBJEKTIVAT DHE FILOZOFIJA E TURIZMIT

Definicioni i Turizmit


Turizmi mundet të definohet si procese, aktivitete dhe rezultatet e ngritura nga marrëdhëniet dhe ndërveprimet përgjatë turistëve, furnizuesve të turistëve, mikpritësve të qeverive, mikpritësve të komuniteteve, si dhe ambienteve përreth që janë të përfshira në atraksionin dhe mikëpritjen e vizitoreve.



Definimi i Turizmit

Turizmi është praktika, veprimi i marrë nga ata që udhëtojnë apo vizitojnë vende me qëllim zbavitjeje, njohurie dhe mësimi; sipas definicionit të **Organizatës Botërore të Turizmit** (World Tourism Organization, një nga departamentet e Kombeve të Bashkuara), **turist** quhet gjithkush që udhëton në vende të ndryshme nga ai në të cilin ka rezidencën aktuale, jashtë ambientit të përditshëm personal, për një periudhë prej minimumi një nate por jo më gjatë se sa një vit dhe qëllimi i tij i zakonshëm të mos jetë asnjë lloj veprimtarie nga e cila të përfitojë ekonomikisht.¹ Në këtë term përfshihen të gjithë ata që udhëtojnë për: dëfrim, pushim dhe çlodhje; për të vizituar miq dhe të afërm; për motive pune dhe profesionale, për motive shëndeti për kohë të lirë, biznes dhe qëllime tjera.

¹Reljac, Mirko&Bartoluci, M.: Turizam i Sportska Rekreacija, Zagreb, 1987, fq.23-26



Vizitori

Një “vizitor” është i përcaktuar nga ata persona te cilët udhëtojnë ne një vend përveç ne ato vende te cilat kane vendbanimin e tyre te zakonshëm për një periudhe jo me shume se dymbëdhjetë muaj dhe ata te cilët qëllimi kryesor i vizitës është ushtrimi i një aktiviteti i paguar (shpërblyer) brenda vendit të vizituar.



Organizimet e Turizmit

Organizimet e Turizmit mund të shihen në mënyrat si me poshtë:

1. Gjeografike
2. Nga pronësia
3. Nga funksioni
4. Nga industria
5. Nga motivi

Organizatat Nderkombetare te Turizmit***Organizata Boterore e Turizmit***

- Organizata me e njohur ne turizem
- Shërben si një forum global
- Transferon njohuritë e turizmit
- Prodhon statistika dhe hulumtim te tregut
- Zhvillon burimet njerëzore te turizmit
- Punon për lehtësime te udhëtimit
- Promovon qëndrueshmerinë
- Krijon projekte te veçanta

Organizatat Zhvillimore**Shembujt:**

- Banka Boterore
- Programi per Zhvillim i Kombeve te Bashkuara
- Banka Aziatike per Zhvillim
- FONATUR (Meksike)
- EMBRATUR (Brazil)

Organizatat Nderkombëtare Regjionale**Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik**

- *Shumica e Anëtarësimit Evropian, mirepo edhe shtetet e Bashkuara, Kanada, Japonia dhe Australia janë poashtu anëtare.*
- **Asociacioni për Udhëtim Aziatik Paqësor (PATA)**
 - *Përfaqëson kombet ne Azi dhe Paqësor.*

Organizatat Nacionale

- Zyra e Industrive te Udhëtimit dhe Turizmit (OTTI)
 - Administrimi Ndërkombëtar i Tregtisë SHBA.
 - Departamenti i Tregtisë
 - Hulumtimi dhe Politika
- Asociacioni Amerikan i Industrisë se Udhëtimit (TIA)
 - Udhëheqje private e organizimit te turizmit ne SHBA
 - Përfaqësimi i tere industrisë se udhëtimit te SHBA-se
 - Promovimi dhe lehtësimi i rritjes se udhëtimi për dhe brenda SHBA-se.
- Komisioni Kanadez i Turizmit
 - Partneriteti publiko-privat
 - Planet, udhëheqjet, menaxhimet, dhe implementimi i programeve për gjenerim dhe promovim te turizmit ne Kanada.

Organizatat Shtetërore

- Te gjitha 50 shtete kanë zyret e promovimit te udhëtimit.
- Shpenzojnë \$695.8 milion ne zhvillimin e turizmit.
- Shohin turizmin si një vegël për zhvillim ekonomik.

Organizatata tjera të Turizmit**Konventa dhe Byroja e Vizitoreve**

** Organizatat umbrell jo profite që paraqesin një qytet apo vend urban ne kërkesën e një shërbimi për te gjitha llojet e udhëtareve ne atë qytet apo vend, nese ata vizitojnë për biznes, kënaqësi apo për te dyja².*

- **Asociacioni Ndërkombëtar i Konventës dhe Byrosë se Vizitorëve (ACVB)**

**Shumica e Qytetit CVBs i takon kësaj organizate.*

Udhëtimi dhe Turizmi

Industria me e madhe e botes

Ne vitin 2001 është vlerësuar llogaritja prej:

- \$3.5 trilion te Aktiviteteve Ekonomike
- 207 milion pune

Ne vitin 2011 është vlerësuar llogaritja prej:

- \$7.0 trilion te Aktiviteteve Ekonomike
- 260 milion pune
- Udhëtimi dhe Turizmi mundë te Dyfishohen në Madhësi nga viti 2011
- Udhëtimi dhe Turizmi do te vazhdojnë te zgjerohen me shpejt si tërësi dhe me shpejt sesa industritë e krahasueshme.
- Ne vitin 2011 Udhëtimi & Turizmi vlerësohet te kenë një llogaritje prej:

**Me shume se dy herë rezultati ne \$7.0 trilion*

**Me shume pune --- 260 milion punonjës*

- Rritja varet nga politika qeverisëse

²Reljac, Mirko&Bartoluci, M.: Turizam i Sportska Rekreacija, Zagreb, 1987, fq.45

Tre Qellimet Kryesore te Turizmit

- 1) Maksimizo shumen e eksperiencës psikologjike për turistet.
- 2) Maksimizo profitet për firmat që ofrojnë ushqime dhe sherime te turisteve.
- 3) Maksimizo ndikimet e drejtpërdrejta (primare) dhe jo te drejtpërdrejta (sekondare) te shpenzimeve te turisteve ne një komunitet apo regjion.

Këto qëllime shpesh janë te qëndrueshme, mirëpo ne situata te caktuara ato munde te jen te pa-qendrueshme.

Qëllimet e Zhvillimit të Turizmit

1. Ofron një kornize për rritjen e standardit te jetës se popullit përmes beneficioneve ekonomike te turizmit
2. Zhvillon një infrastrukture dhe ofron lehtësime rekreacionale për vizitorët dhe vendasit
3. Siguron zhvillimin brenda qendrës se vizitoreve dhe resorteve ne këto vende
4. Themelon një program te qëndrueshëm zhvillimi me një filozofi kulturore, sociale dhe ekonomike si dhe njerëzit e atij regjioni
5. Optimizon kenaqshmerine e vizitorit

Efektet Negative Sociale të Turizmit në një Shoqëri Mikëpritëse

1. Paraqitja e aktiviteteve te padëshirueshme si si loja te rrezikshme
2. Efekti i demonstrimit
 - *Njerëzit lokal deshirojne luksin e njëjtë dhe mallrat e importuara sikurse atyre te turisteve*
3. Tendosja racore
4. Zhvillimi i një qëndrimi te nënshtruar ne pjesën e punonjësve te biznesit te turistit
5. *Xhingellima e arteve dhe zanateve*
6. Standardizimi i roleve te punonjësve
7. Humbja e krenarisë kulturore
8. Ndryshimet e shpejta ne mënyrat lokale
9. Numrat e pabarabartë të punëtoreve me page të ulët ne punët e pastrimit

Barrierat e Udhëtimit

1. **Kostoja** – per shum familjar kostoja eshte nje nder problemet kryesore per turizem, gjendja financiare dhe ekonomike i ben qe mos te vezitoin vendet qe ata preferojn.
2. **Mungesa e kohës** -Ne ditet e sotme njerezit jane gjithmone nen trysnine e kohes dhe ndjehen te mbytur ne pune pa arritur rezultatet qe do te justifikonin mundin.
3. **Kufizimet shëndetësore** - eshte nje nder problemet serjoze qe njeriu smundet qe te merret me turizem dhe te shkoj ne pushime, per shkak semundjeve qe posedon organizmi i tij
4. **Mungesa e interesimit** – kjo eshte nje nder barrierat qe njeriu smerret me turizem pershkak mos interesimit per turizem
5. **Frika dhe siguria** – jane barriera te cilat çdo vizitor e pengojn per te shkuar ne vendin e caktuar aty ku ka vendosur per ta vizituar. Faktoret qe nje vizitor ndjen frik dhe pasiguri jane: konfliktet dhe luftrat qe ndodhen ne ate vend ku vizitori deshiron te shkoj.³



³Kerić Borka Mara: Efekti programiranog vežbanja na produktivnost rada, fq.62-65.

5 destinacionet kryesore te Turizmit të Botës 2000

Franca

Shtete e Bashkuara

Spanja

Italia

Kina

5 perfituesit Boteror te Turizmit 2000

Shtete e Bashkuara

Spanja

Franca

Italia

Anglia

SHTATE ÇUDIRAT E BOTES ANTIKE

- **Piramidat e Mëdha te Egjiptit (perfshire edhe Sfinksin)**

Periodha e piramidave fillon gjatë Mbretërisë së Vjetër (2650-2134 para Krishtit), kur piramidat e para u ndërtuan nga Mbreti Djoser në dinastinë e tretë. Ndërtimi i tyre vazhdoi deri në vitin 1640 para Krishtit. Gjatë dinastisë së parë dhe të dytë, mbretërit egjiptianë varroseshin në varre të vjetër prej balte. **Egjiptianët** e lashtë i ndërtonin piramidat, varret, tempujt dhe pallatet me materiale ndërtimi mjaft të qëndrueshme. Ndërtimi i piramidave kërkonte një shkallë të lartë aftësisë në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë. Përveç piramidave, ndërtesat egjiptiane ishin të zbukuruar me piktura, imazhe të gdhendura prej guri, hieroglifë dhe statuja tri-dimensionale. Arti tregon historinë e faraonëve, perëndive, njerëzve të thjeshtë, botën natyrale të bimëve, zogjve dhe kafshët. Bukuria dhe madhështia e këtyre vendeve nuk mund të krahasohen. Si ka mundësi që egjiptianët e lashtë arrinin të ndërtonin këto struktura masive duke përdorur rregulla primitive? Kjo mbetet ende një mister. Piramidat spektakolare, të cilat e kanë bërë Egjiptin të famshëm, janë një prej mrekullive më të vërteta të botës. Një prej mistereve më të lashtë në Egjipt, ka të bëjë me ndërtimin e piramidave. Si ishte e mundur që njerëzit në periudhën e Gurit, të lëviznin blloqe kaq të mëdha guri? Egjiptianët lanë mijëra vizatime nga jeta e tyre e përditshme në Mbretërinë e Vjetër. Çuditërisht në asnjë prej tyre nuk tregohet se si janë ndërtuar piramidat. Edhe sot, piramidat janë metafora për kërkimet e njerëzimit. Piramidat e fundit u ndërtuan rreth Dahshur-it dhe Haware-s nga mbretërit e Mbretërisë së Mesme ⁴(2040-1640 para Krishtit). Megjithë përpjekjet e konsiderueshme për të fshehur hyrjen për në varre, si dhe përpjekjet për të zbrapsur grabitësit me leje kalimi false, arkitektët dështuan të parandalonin plaçkitjen e piramidave. Si rezultat i kësaj, piramidave njëmijë vjeçare po u vinte fundi. Eksperimenti për të siguruar udhëtimin e mbretërve në përjetësi, doli i jo i suksesshëm. Për këtë arsye Faraonët e Mbretërisë së Re iu përkushtuan ndërtimit të varreve në Luginën e Mbretërve. Në një zonë të largët përtej Nilit, nga Luxor dhe Karnak, ata shpresonin t'i shpëtonin fatit të keq të paraardhësve të tyre.

⁴<http://sl.wikipedia.org/wiki/>



Qyteti i lashte i Gizes - Giza është qytet arab ne Egjiptin e lashtë, i cili ndodhet shumë afër lumit Nil. Nuk është edhe aq qytet i madh me sipërfaqe , ka afër 2 milion e 700 mijë banor sipas një statistike të bërë në vitin 2006. Popullsia e saj e madhe ne raport me sipërfaqen e bënë përafërsisht një ndër krahinat e qyteteve më te mëdha në botë sa i përket numrit të popullsisë. Ky vend ka jashtëzakonisht shumë vizitor, dhe pret nga e gjithë bota studiues, arkeolog, arkitekt, shkencëtar, dhe shumë të tjerë që janë të interesuar për studimin e pasurisë së vjetër të këtij qyteti. Njihet si një ndër vendet më të famshme në botë, për arsyet se këtu gjendet një ndër mrekullitë e botës antike, që zakonisht njihet me emrin “kompleksi i piramidave të Gizës”. Ky tempull bashkë me piramidën e madhe të Keopsit, dhe me disa tempuj të tjerë, kanë shkruar historinë e Egjiptit, dhe kanë ngjallur debat në të gjitha shoqëritë, mbi prejardhjen e këtyre ndërtimeve antike, misteri që mundon sot njerëzit anë e mbanë. Gjithashtu ky është edhe vendbanim i shumë faraonëve të lashtë egjiptian, për të cilët historia që njohim flet vetëm me supozime e me fakte të thata. Ka shumë e shumë te panjohura mbi këtë vend të cilat edhe sot e kësaj dite, s’gjejnë dot zgjidhje. Ekzistojnë shumë teori të cilat mundohen të shpjegojnë mënyrën e ndërtimit të piramidave, përveç të tjerash, puna vije edhe aty, saqë thuhet nga disa shkencëtar se ato janë ndërtuar nga skllavet egjiptian (rreth 2 milion te tillë) nën udhëheqjen e një race tjetër. Më poshtë do të paraqes strukturën e piramidave (tre sa janë gjithsej), dhe mendimet e shkencëtarëve në lidhje me këto ndërtime të rralla.



Piramidat e Gizes

Në këtë kompleks bëjnë pjesë gjithsej 6 piramida (prej tyre 3 të mëdha). Më e madhja nga to është piramida e madhe e Gizës e cila njihet me emrin “piramida e Keopsit” , me 1380000 metra katror, dhe e cila përbëhet prej 2 milion gurëve secili me 2 ton peshe, e në disa raste pesha e gurit shkon deri në 30 ton, peshë të cilën vështirë se e bart edhe një kamion i madh. As sot në shek. XXI nuk krahasohet dot, bile janë xhuxh çdo ndërtesë tjetër në botë më të për madhësi, peshë, e përpikmëri matematikore. Piramida e madhe e Gizës peshon 6 milion ton, më shumë se çdo gjë që ka ndërtuar njeriu deri më tani. Ato janë aq të mëdha sa mund të shihen edhe nga stacioni ndërkombëtar hapësinor, madje edhe nga Hëna. Besohet se në të kaluarën piramidat kanë qenë të zbukuruara me ar të pastër, e me gurë tjerë tepër të çmuar. Struktura e piramidës përmbante informacione që do të zbuloheshin pas shumë shekujsh. Deri më sot është menduar se këto struktura gjigante janë produkt dhe rezultat e dijetarëve të lashtë egjiptianë, dhe i një fuqi punëtore me rreth 2 milion skllavë. Pikën e parë shumë shkencëtar po e sfidojnë bukur, duke cituar se struktura e piramidës dhe shumë detaje të saj nuk i përshtaten aspak kohës, dhe teknologjisë së atëhershme. Duhet pasur gjithmonë parasysh se edhe sot për ndërtimin e një piramide (si ajo e Gizës) duhet një sfidë e vërtet në inxhinieri e arkitekturë. Sot ndërtohen shumë pak ndërtesa me formë piramide, sepse paraqet vërtet një vështirësi. Njihet, një piramidë moderne e madhe (shumëfish më e vogël se piramida e madhe e Gizës) është ndërtuar në Las Vegas, të tjerat janë të pakta, apo shumë të vogla. Këto piramida moderne punohen vetëm me anën e makinave të mëdha, dhe me anën e gjeometrisë së përpiktë e ligjeve matematikore.

Atëherë si kanë mundur egjiptianët të ngrinin këso lloj strukturash, vetëm me anën e fuqisë punëtore dhe mjeteve tepër të thjeshta të asaj kohe? Si kanë mundur të ushqenin një numër aq të madh njerëzish? Kësaj pyetje ende nuk është mundur t'i gjendet një përgjigje. Piramidat e Gizës thuhet se janë ndërtuar gjatë dinastisë egjiptiane, 4.500 vjet më parë. Bëjnë pjesë në 7 mrekullitë e botës antike, vend ku sekretet dhe të panjohurat për kohën gjendet më shumë se çdo kund tjetër. Flitet se këto piramida janë ngritur nga po ata arkitekt që ngritën edhe piramidat e tjera të këtij vendi, për nderimin e faraonëve të vdekur, dhe si vend ku ata do të marrin rrugën drejt perëndisë e përjetësisë. Sipas shumë studiuesve e shkencëtarëve nga e gjithë bota, në piramidë gjendet e kaluara dhe e ardhmja e njerëzimit. Në kohët e kaluara është menduar se në Piramidat egjiptiane gjenden pasuri shumë të çmuara sikur arë e thesare, por kjo ende nuk është vërtetuar, më përkatësisht në piramidë nuk është gjetur asgjë e çmuar. Sipas vëzhgimeve të fundit shkencore poshtë sfinksit gjendet një dhomë misterioze, për të cilën ende nuk është njohur gjithçka. Nga disa studiues mendohet se nën piramidë është dhoma e ashtu quajtur "dhoma e dijeve" ku gjenden të gjitha informacionet mbi sekretin e piramidave, dhe mbi zhvillimin e gjithëmbarshtëm të njerëzimit, por sipas legjendës kjo nuk duhet hapur, sepse siç thonë mund të jetë dita e gjykimit dhe e shkatërrimit të plotë të shoqërisë njerëzore. Shkenca konstaton se ekziston "dhoma e dijeve", por pa këtë shtesën e fundit imagjinare. Shkenca supozon se në fillimet e tij kompleksi i Gizës duhet të ketë qenë diçka tepër e bukur, dhe sipërfaqja e vrazhdë e piramidës duhet të ketë qenë, pasqyrë e lëmuar, sipas konstatimeve shkencore. Tempuj të mëdhenj, piramida super të mëdha, dhoma të nëndheshme etj. Robert Bauval, një inxhinier dhe autor i librit "Mesazhi i sfinksit", pasi vizitoj dhe studioi me hollësi piramidat e Gizës, dhe pasi analizoi me kujdes ato, tha se është diçka tepër misterioze se përse nuk mbeti asnjë shënim mbi konstruktin e piramidave, përse nuk u gjet asnjë mbishkrim, asnjë dokument? Është vërtet e pakuptimtë që egjiptianët përshkruanin çdo gjë që shihnin madje edhe lumin teksa rridhte, edhe ndërtimin e shtëpive, edhe kanalet e ujit, e Nilin, kurse asnjë dokument nuk u gjet kurrë për piramidat të cilat duheshin konsideruar diçka shumë madhore, nga vetë fakti që në to punuan 2 milion e më shumë⁵ egjiptian. Si është e mundur kjo? Pastaj Ryder Gryem Hancock, gjithashtu studiues kishte të njëjtin mendim me Bauvalin, ai thotë se, egjiptianet nuk do të ndërtonin diçka kaq madhore, e ta linin në errësirë, mos ta tregonin mënyrën e ndërtimit. Sepse edhe vetë praktika tregon se egjiptianët do ta përshkruanin sigurisht ditën kur do të ngriheshin piramidat, por kjo nuk ndodhi, mos vallë ndërtuesit nuk kanë qenë egjiptianët? Thuhet se civilizimi i Egjiptit filloi 3000 vjet para lindjes së Krishtit, diku rreth 500 vjet para se të ndërtoheshin piramidat e Gizës. Në historinë e tij Egjipti i lashtë ngërthen një kulturë unike, krejtësisht ndryshe nga popujt e tjerë. Këtu besohej në disa perëndi ndër të cilat ishte edhe perëndia "Ra", perëndia e diellit e cila ishte mbi të gjitha.

⁵<http://sl.wikipedia.org/wiki/>

Këtu popullata ndodhej në kohën e gurit, respektivisht koha dhe teknologjia ishin në atë pikë sa që ende nuk ishte zbuluar rrota, mjete më i thjeshtë për transport. Bauvalin e mahniti fakti se e gjithë ajo strukturë gjigante është ngritur vetëm për t'ia siguruar varrin një faraoni, kjo është diçka shumë e çuditshme për të, bile edhe e pabesueshme. Ai mendon se piramidat në Gize kishin edhe një funksion tjetër. Ka të tillë që mendojnë se piramidat janë ngritur si stacione për një racë tjetër, sepse edhe ashtu vendi është tepër i përshtatshëm për një eksplorim të një race tjetër, pikërisht në qendër të tokës, në një terren të rrafshët e pa lugina të mëdha. Disa të tjerë mendojnë se Piramidat janë përdorur vetëm si hambar për grurë, por kjo zgjidhje besohet shumë më pak nga njerëzit. Dhe një supozim tjetër thotë se ato janë përdorur si observator astronomik. Deri vonë piramida e madhe e Gizës (Khufu) kishte qenë ndërtesa më e lartë në botë, deri sa u ndërtua në Paris Kulla e madhe e Ajfelit. Tri piramidat e mëdha të Gizës përcaktojnë saktësisht, në mënyrë matematikore katër drejtimet globale: Perëndimin, Lindjen, Veriun e Jugun. Gjenden në mënyrë milimetrike në vijën e paramenduar ekuatoriale të tokës, vijë e cila e ndan tokën në dy pjesë të barabarta. Pikërisht “kompleksi i piramidave të Gizës” gjendet në qendër të tokës. Në piramidat e Gizës ekziston një sistem tepër i ndërlikuar pastrimi i ajrit në strukturën e brendshme të Faraonit. Ai sistem është tepër komplekse dhe shumë i avancuar, që nuk përshtatet aspak me kohën e atëhershme. Përbëhet nga mija thyerje e lakime të gurit, në mënyrë që ajri të pastrohet sa më lehtë, dhe dhoma në të cilën qëndron faraoni të jetë sa më e freskët. Ky qëllim i tyre është arritur. Tunelet nën piramidë janë po aq misterioze sa vetë piramidat... Për të hapur një tunel në kohën tonë, kërkohet një vend që përbëhet prej gurëve tepër të fortë e të ngjitur fort njëri me tjetrin në mënyrë që tuneli ta këtë të vështirë të shembet, sot shumë vështirë bëhet ai në hapësira ku nuk ka gurë. Megjithatë egjiptianët para 5000 vjetëve kanë arritur të ndërtojnë tunel super të gjatë në rërë, që sot është tepër e vështirë kjo. As këtij fakti nuk i gjendet sqarimi, bile është diçka e pamundur të ndërtohet nga njerëzit me teknologjinë e atëhershme, sipas gjykimit të Bauvalit, Ham Cock-ut, dhe Doktor Ivanovicit. Doktor Ivanovic është një ndër pjesëmarrësit, në projektin tepër sekret, që njihet me emrin “ISiS”. Ai është gjithashtu autor i librit po me këtë emër. Ai citon se në vitin 1961 në piramidën e madhe të Gizës është gjetur një krijesë jo njerëore në arkivolin e faraonit Khafu. Për këtë Dr. Ivanovici ka edhe dokumente zyrtare të KGB-së, dhe video – materialin mbi këte ekspedite. Kjo ekspeditë është organizuar nga organet sekrete të KGB-së së Rusisë. Projekti ISiS ishte projekt shkencor, i cili është formuar gjithsej për tre arsye: -për kërkime shkencore për fuqitë telepatike -për dosjet UFO dhe. -për piramidat në Egjipt. Ekspedita në vitin 1961, pasi kishte hapur arkivolin e Khafus, i cili qëndronte ashtu për 5 dekada, pasi kishte marrë kufomën, dhe pasi kishte studiuar me hollësi atë KGB-ja, rezultatet tregonin se krijesa e gjetur nuk ishte njeri, edhe pse kishte karakteristika të përbashkëta me njeriun. Për këtë informacion edhe pse burimet janë të sigurt ende ky fakt është në një errësirë, dhe në një paqartësi.

Sipas Dr. Ivanovicit këtu kemi të bëjmë me zbulimin më të madh të njerëzimit, me shkeljen e një humanoidi jashtëtokësor në tokë, i cili la dijet e njohurit tek qytetërimi egjiptian. Gjatë kësaj ekspedite është vërejtur edhe nje fakt tjetër: Nga shkëmbi buronte një forcë magnetike, për te cilën shkenca ende nuk ka dhënë shpjegim. Ajo forcë magnetike buron edhe sot nga shkëmbinjtë e lashtë të piramidës së madhe. Gjithashtu Ivanovici thotë se KGB-ja zbuloi prova dhe argumente të pakundërshtueshme, që Egjipti u zhvillua mbi një trashëgimi dijesh, të një race jashtëtokësore. Kjo teori shumë besohet nga njerëzit, dhe është shumë e mundur që në të kaluarën kemi qenë të vizituar nga një racë jashtëtokësore, tek e fundit kjo si mundësi pranohet edhe nga shkenca. Sipas po këtij studiuesi alienët nuk erdhën në tokë për t'i parë piramidat e Gizës, por për t'i ndërtuar ato, si stacione jashtëtokësore për eksplorim ndërplanetar. Ja të shikojmë mundësitë që njeriu atë stad të zhvillimit mund të ndërtoi diçka kaq gjigante. Problemi fillestar apo misteri fillestar më mirë të themi, është lëvizja e gurëve ku si mesatare po marrim 5 ton një gurë. Teoria e parë ishte tërheqja me litar, kjo mundësi bie poshtë, sepse është vërtetuar se nuk ka asnjë mundësi teorike që të lëvizet një shkëmb nga dhjetëra e njerëz me peshën mbi 3 ton, vetëm nëse në fuqinë shtytëse do të ishin qindrat, dhe në këtë çast bëhet e palogjikshme sepse kohëzgjatja do të ishte me mijëvjeçar e jo me dekada për sa janë ndërtuar. Teoria tjetër thotë se janë përdorur drunjtë e pemëve për lëvizjen e këtyre shkëmbinjve gjigante. Është konstatuar shkencërisht se në qoftë se kjo mundësi do të ishte shfrytëzuar, atëherë vetë grumbullimi i drunjve të pemëve, dhe bartja e tyre do të ishte projekt shumëfish më gjigant se sa vetë piramidat, prandaj edhe kjo mundësi nuk pranohet si e logjikshme. Pastaj kur të përmendet fakti se Egjipti është një ndër vendet më të varfra në botë sa i përket numrit të pemëve.



- **Kopshtet e Varura te Babilonise**

Kopshtet e varura të Babilonisë janë ndërtuar rreth 590 p.e.s nga mbreti Nebukodonosor II (edhe pse tradita atributet e ndërtimit të tyre ia jep Mbretëreshës Semiramide, asire). Legjenda tregon që mbretëresha - përshkruar dhe në pikturën e famshme të Degas, "Semiramide në ndërtimin e Babilonisë", çka përshkruhet e në opera lirike - gjente trëndafila të freskët në kopshte çdo ditë, madje edhe në klimën e thatë që karakterizonte qytetin⁶. Duhet të theksohet se në kulturën tradicionale të Mesopotamisë, kuptimin e fjalës i ngjan kopsht të Xhennetit, parajsës. Disa historianë, duhet thënë, se nuk janë dakord për ekzistencën ose jo të kopshtet mbretërore të qytetit të Babilonisë. Çështja e vendndodhjes së kopshteve është akoma e pazgjidhur dhe studime, ende në vazhdim, kanë lëshuar shumë hipoteza, përfshirë edhe atë që nuk ndodheshe brenda në Babiloni, një nga shtatë mrekullitë e botës antike.


Nga burimet e lashta, informacionet për kopshtet nuk flasin askund se ku ndodheshin ato. Duke pasur parasysh se në atë kohë, përdorimet e tokës ishin bujqësore, krijimi i një kopshti botanik ishte diçka e pazakonte. U krijua një kopsht botanik me llojet e bimëve me origjinë nga vende të tjera dhe që jetonin në klimat më të lagështa. Prandaj u ndërtua një sistem kompleks hidraulik që, mes tjerash, ishte për të ngritur ujin nga lumi e për të çuar ujin në kopshtet ; me shpeshtësinë dhe sasinë që nevojitej. Terracat e Kopshteve ishin ndërtuar krejtësisht prej guri dhe janë përmendur edhe nga Herodoti.



⁶<http://sl.wikipedia.org/wiki/>

- **Varri i Mausolus ne Halicarnassus**

Viti 352 para e.s.. Mrekullitë e botës, që në këtë kohë ishin katër, pakësohen në 3, sepse Erostrati djeg tempullin e Artemisë. Por zhvillimi është duke ardhur: një mrekulli e re do të ndërtohet, me shumë coincidenca me tempullin e Artemisë dhe do të duket si një vepër e bërë me magji për të kompensuar humbjen. Jemi në Halicarnaso, në Caria, një shtet në Azinë e Vogël. Bëhet fjalë për një qytet të rëndësishëm, që llogariste dhe një fabrikë nga ato të disqeve të çuditshme të metalit të shpikura nga Creso që prodhojnë para. Qyteti shfaq shkëlqim. Por tani qyteti është në zi, Mausolo vdiq. Çfarë varri mund të ishte i denjë për një mbret të tillë? E veja e tij, Artemisa, merr vendimin që të mos kursehet në shpenzime. Është tamam sikur i gjithë qyteti ta dinte që kurrë më nuk do kthehej një epokë aq e mrekullueshme si ajo e Mausolos, prandaj njerëzit u vunë në dispozicion të demonstrosin mirënjohjen dhe t'i bënin një varr, më specialin e historisë, aq sa i dha emrin mauzoleumeve të ndërtuara më vonë. Filluan punimet: arkitektët Satiros dhe Piteos ndërtuan një podium kënddrejtë mbi të cilin ngrihej një kolonë e rregullit jonik. Mbi këtë një piramidë e shkallëzuar. Dhe në majë një statujë. Bashkësia e të gjitha këtyre arrinte lartësinë marramendëse prej 50 m. Por kjo nuk ishte e gjitha. Skulptorët më të mirë të Greqisë të asaj epoke bënë statujat dhe mozaiket: Briaxis, Timoteo, Leucastes dhe famozi Scapo. Por kjo mrekulli do të ishte ajo që duroi më pak në kohë nga të gjitha. Sapo kaluan 16 vjet, më 334 para e.s., Aleksandri i Madh shkatërroi qytetin. Ai që dha urdhër për rindërtimin e tempullit të Artemisë tregon tani anën e tij shkatërrimtare. Edhe pse vite më pas mbretërit e Egjiptit që morën Carian e rindërtuan Halicarnason, qytet që është edhe në ditët tona (sot quhet Bodrum), nga mauzoleumi ngeli vetëm legjenda.




- **Shtatorja e Zeusit ne Olimpia**

Shtatorja e Zeusit në Olimpia gjendet në tempullin e ndërtuar, kushtuar zotave në qytetin grek të Olimpit, shtatorja u bë në vitin 462 p.e.s. nga skulptori antik grek, Fidis, në fildish dhe arë. Ajo është e punuar me teknikën krisoelefantine. Zeusi paraqitet i ulur në një fron të bërë me të njëjtat materiale si dhe statuja që paraqiste perëndeshën Victoria të lidhur në krahun e djathtë dhe në të majtën skeprit, rreth tij ishin skulptura të ndryshme të heronjve mitologjikë. Skulptura kishte lartësi prej 14 m. Sipas historianëve të autorizuar, ishte më e bukura skulpturë dhe riprodhimi i saj njihet vetëm në monedha të takuara në shekullin XIX. Jetoj rreth 1000 vjet (më shumë se të gjitha mrekullitë e tjera) derisa disa fanatikë kristianë të mbretërisë të Teodosit II e dogjën, por ajo nuk u shkatërrua totalisht. Zhdukja totale ndodhi në shekullin VI dhe nuk ngeli asnjë gjurmë e saj si pasojë e tërmeteëve. Statuja ka shërbyer për shumë vjet për të kurorëzuar fituesit e olimpiadave greke.



- **Kolosi i Rodosit**

Vendndodhja gjeografike e Rodit ishte e privilegjuar për të tregtuar me Greqinë. Azia dhe Egjipti falë kësaj e shndërruan në qendrën tregtare më të madhe të Mesdheut Oriental. Mbreti Demetri i Poliarctës, i njohur për eksperiencën ushtarake sidomos nëpër rrethinat, aq sa në të ardhmen ushtarakët do t'i referoheshin teknikës së tij duke e emërtuar "Poliarctica", vendosi të sulmojë Rodin⁷. Qyteti i rezistoi dhe Demetri u detyrua të tërhiqej. Për të festuar këtë triumf, qyteti vendosi të ndërtonte një monument për kujtim të Helios, zoti i diellit, në port. Punimet i udhëhoqi Cares Lindos. Në fillim statujën e veshën me hekur dhe sipër me pllaka bronzi. Më në fund, kur statuja përfundoi, kishte jo më pak se 32 m lartësi. Fama e saj solli udhëtarë nga e gjithë bota antike për ta parë. Me Kolosin e Rodit në atë kohë ishin 5 mrekullitë e botës që ishin ngritur mbi faqen e tokës, numër që erdhi duke u rritur. 56 vjet më vonë nga ndërtimi i tij në 223 para e.s., një tërmet e shëmbi Kolosin. Banorët e Rodit ndoqën këshillat e një orakulli dhe vendosën t'i lënë pjesët e tij atje ku ranë nga tërmeti. Dhe kështu u bë gjatë 90 vjetëve deri në 654 para e.s., kur myslimanët morën copat e bronzit si plaçkë lufte. Madhësia e statujës ishte e tillë sa që anijet kalonin mes këmbëve të tij. Kolosi i Rodit nuk ka nevojë për mitifikim, sepse u deshën më shumë se 2000 vjet kur njeriu arriti të bënte diçka më madhështore.



⁷<http://sl.wikipedia.org/wiki/>

- **Farki i Aleksandrisë**

Egjypt, viti 280 para e.s. Që kur Aleksandri i Madh i liroi egjiptianët nga dominimi persian, lidhjet mes grekëve dhe egjiptianëve u forcuan aq shumë sa mbreti i tyre, Ptolomeu II, ishte me origjinë greke. Ky bashkëpunim i grekëve dhe egjiptianëve ishte më i dukshëm në kryeqytet, Aleksandri. Themeluar prej Aleksandrit të Madh në vitin 332 para e.s., ky qytet i zhvilluar u bë vatra më e rëndësishme e kulturës helene. Por këtë herë mrekullia nuk do të jetë një tempull, as ndonjë lloj tjetër monumenti ose ndërtesë, por një kullë. Kjo kullë do të shërbente për të udhëhequr anijet e shumta që mbërrinin në brigjet e Aleksandrisë. Mbreti vendosi të ndërtonte një kullë që të identifikonte vendin dhe qytetin nga shumë larg.

Për këtë përdorën ishullin e vogël të Faros, përballë portit. Arkitekti Sastro drejtoi punimet, që, sa më shumë ecnin jepnin një pamje të mrekullueshme. Kur përfundoi, kulla ishte më shumë se 120 m. Në majë të saj kishte pasqyra metalike për të treguar pozicionin e saj ditën, duke reflektuar dritën e diellit dhe natën për mungesë të dritës ndizej zjarr (vatër). Kjo mrekulli do të rezistonte shumë, rreth 1600 vjet deri në shekullin XIV, kur tërmetet do ta shembnin. Emri i mrekullisë ishte "Kulla e Farit" dhe i linte mbrapa të gjitha ndërtimet e bëra deri në atë kohë që kishin për qëllim të udhëhiqnin anijet.



- **Tempulli Artemmidës në Efes**

Në shekullin VI para e.s., ky qytet ka qenë gjithmonë qendra e kultit të Afërditës, e quajtur më vonë Diana nga romanet. Flitet për perëndeshën e natyrës dhe kafshëve të egra dhe paraqitet e shoqëruar nga një sorkadhe dhe e armatosur me hark dhe shigjeta. Nga antikiteti ekziston një tempull i dedikuar perëndeshës. Por në shekullin VII para e.s., qyteti pësoi një sulm nga cimerët. Edhe pse qyteti rezistoi, tempulli u dogj dhe u shkatërrua. Gjithçka ishte në duart e mbretit të Lidias, Kreso. Po, është i njëjti që ka shpikur disqet e çuditshme prej metali të quajtura "kreseidas". ⁸Asnjë nuk e di se ku do ndalojnë këto shpikje moderne... por Kreso ishte një mbrojtës i shenjtëve dhe artistëve dhe ai propozoi të ngrihej një tempull i ri i Artemisës, më i mirë se i pari. Për këtë u bë një thirrje publike ku u kërkohesh të gjithë qytetarëve që të dhuronin para për tempullin e ri. Më në fund tempulli u ngrit. Llogariste 127 kolona të mrekullueshme nga 20 m lartësi, diçka e jashtëzakonshme për kohën, gjithashtu përmbante dhe skulptura të Eskopes.



⁸<http://sl.wikipedia.org/wiki/>

Ky tempull shkëlqeu qytetin e Efesit gjatë dy shekujve. Pa dyshim vjen tragjedia : në vitin 356 para e.s., bariu Erostrato e shkatërroi tempullin duke e ndezur thjesht për famë. Pa dyshim që ky pionier i famës e arriti atë që kërkonte, provë është që ende i kujtohet emri edhe sot. Por në atë kohë arriti diçka më shumë se fama : duke u treguar të gjithë njerëzve që për çudi Escopa ka një Erostrato dhe që mrekullitë e ndërtuara nga njerëzit duhet të jenë të mbrojtura nga vetë njerëzit. Kjo histori ka një epilog : kur rreth 20 vjet më vonë, Aleksandri i Madh pushtoi qytetin e Efesit, dëgjoji historinë e tempullit dhe zbuloi që tempulli ishte shkatërruar në të njëjtën ditë që kishte lindur ai. Kjo koincidençë e bëri që ta rindëronte tempullin gjatë kohës që ishte në Efes, duke u përpjekur të krijonte një qeveri demokratike. Edhe pse mbaroi, tempulli (bëhet e treta herë me këtë rindërtim) nuk e rimori kurrë të shkuarën e tij të shkëlqyer.

5. FILOZOFIJA E TURIZMIT

Rëndësia e turizmit si fenomen socio-hapsinor e ekonomik dhe perspektiva e tij, është vështirë të shiqohet edhe pas një shekulli të qëndrimit të tij. Megjithatë, sigurisht që turizmi sot kryen funksion shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të secilit vend, qoftë ajo receptive apo iniciale. Si “ndarje e veqantë shoqërore e punës” turizmi, pos tjerash, potencon udhëzim dhe lidhshmëri ndërmjet veti të tërësive të ndryshme hapsinore ekonomiko-gjeografike. Turizmi është mundësi e shfrytëzimit të të mirave joproduktive, sepse nëpërmjet turizmit disa hapsira atraktive fitojnë vlerën e pasurive natyrore, ndërsa me këtë edhe vlerën e tyre ekonomike.

Mu për këtë shumë vende shohin në turizëm shansin dhe mundësin e kyqjes së shpejtë dhe me sukses në ndarjen ndërkombëtare të punës. Turizmi ka efekte të rëndësishme me përmasa ndërkombëtare, në përmirësimin e bilansit të të ardhurave të një vendi, pastaj mundësin e absorbimit të tepërt (tepricës) së fuqisë punëtore në lëmin e receptive turistike, në stabilizimin e tregut të brendshëm (përmes ndarjes së të ardhurave) etj.⁹ Turizmi gjithashtu direkt ose indirekt ndikon në disa degë ekonomike (në komunikacion, tregëti, industri, bujqësi, pylltari). Klientiteti turistik kryesisht bëhet për shkak të nevojës për pushim dhe kultivim. Analogjikisht, kësaj duke përcjellë definimin themelor të turizmit “Grup mardhënjeshe dhe dukurish lidhur me lëvizjen dhe shpenzimin jashtë vendit me qëndrim të përkohshëm, e për qëllim të plotësimit të nevojave rekreative dhe kulturore”

⁹Mithad Blagejac “TEORIA SPORTSKE REKREACIJE” Novi Sad 1994, fq.83-87

6. LLOJET E TURIZMIT

Pa mëdyshje se turizmi në botën bashkëkohore paraqet një ndër dukuritë shoqërore e ekonomike më masovike e dinamike. Kjo është një ndër veprimtaritë e rralla ekonomike në botë e cila që nga viti 1950 ka rritje të përhershme të pjesmarrësve dhe qarkullimit, në shumë vende ka rritje bile edhe më të madhe se në lëmi të tjera ekonomike. Megjithatë, nuk është vetëm veprimtari ekonomike, ai është karakteristikë për funksionalitetin e shumë ndryshëm të tij.

Të gjitha këto funksione varen dhe gërshetohen në mes vete. Kërkesat bashkëkohore turistike gjithnjë e më shumë nisen nga motive edhe dëshira e shfrytëzuesit turistik, dhe mundohen ti i plotësojnë kërkesat e tyre, sepse kjo është garancioni i vetëm që shërbimi i premtuar i përgjigjet kërkesave dhe kështu të mbyll ciklin reproduktues të turizmit.

Llojet e turizmit vazhdojnë me kërkimin motivues të shfrytëzuesit, gjegjësisht turistëve potencial, qka është njëri ndër komponentet më të rëndësishme të planifikimit në turizëm.¹⁰ Kështu mund të dallohen ato motive dhe dëshira të cilat formojnë kërkesat me përmbajtje më të ndryshme të cilat më së miri do ti përgjigjen kërkesave të tregut. Duke pasur parasysh që kërkesa turistike është shumë e përbërë dhe se vazhdimisht ndërron, kërkesa turistike duhet të jetë e përshtatshme, e aftë të reagoj në të gjitha ndryshimet dhe në kërkesat e tregut turistik. Kjo ndërhyrje në turizmin bashkëkohor ka shkaktuar ndërrimin e mardhënjeve në kërkesat turistike. Përmbajtja e qëndrimit të turistit gjithnjë e më tepër mbetet komponentë themelore, gjithnjë e më pak janë kërkesat klasike turistike, dhoma hoteliere, restorane, plazha. Shërbimet turistike janë më afër mysafirit “gjithëkund“ e përcjellin, i ofrojnë shërbimet e tyre edhe me përgaditje solide të programuara. Ekonomia bashkëkohore turistike është rritur në metodën e vjetër të pritjes së musafirëve dhe tash ju ofron shërbime të shumta përmbajtësore. Përfundimisht, ka mbizotëruar mendimi se musafiri më i mirë është ai i cili shkon i kënaqur.

Llojet e turizmit mbeten si kërkesë e kohës për krijimin e atyre ofrimeve turistike të cilat nxisin motivacion themelor gjatë ardhjes së musafirëve ose edhe dukshëm e plotësojnë. Llojet e turizmit nuk guxojnë të jenë të imponuara turistëve, por para së gjithash duhet të jenë të formuara sipas dëshirës së tyre, shprehive, por edhe me plotësimin e interesit ekonomik të dhënësit të shërbimeve. Ato vazhdimisht duhet ti përshtaten kërkesës turistike. Për këtë në programimin e kapaciteteve të reja turistike dhe përmbajtjeve të reja duhet filluar në hulumtimin e tregut turistik. Në praktikën e turizmit bashkëkohor dhe definimin e llojeve të turizmit, për këtë kujdesë të veçantë i kushtohet motiveve dhe motivacioneve në turizëm të cilët janë inspirim vendimtar për lëvizje turistike.

¹⁰Mithad Blagejac “TEORIA SPORTSKE REKREACIJE” Novi Sad 1994, fq.113-119.

Llojet e Turizmit

- Turizmi Ekonomik
- Turizmi Social
- Turizmi Kulturor

6.1.1. Kategoritë e Turizmit**6.1.2. Turizmi bregdetar**

Klima e pershtatshme ndikon ne menyre stimulative ne organizmin e njeriut, andaj hapesirat bregdetare jane zona te qarkullimeve me te medha turistike ne bote. Per here te pare mjeku Turtel ka filluar ne France te propagandoje vleren e Talasoterapise per sherimin e semundjeve te ndryshme te organizmit te njeriut, kurse Napoleoni III i pari ka filluar te lahet ne det per qellime rekreative. Sot turizmi bregdetar ka marre hov te zhvillimit ne te gjitha vendet boterore ku egzistojne kushtet e pershtatshme.



6.1.3. Turizmi kulturor

Llojlojshmeria e pasurive kulturore dhe krijimet artistike paraqesin deshmi te rendesishme te qyteterimeve. Pasuria kulturore perkufizon identitetin e nje bashkesie njerezore e cila perben nje resurs te cmuar i cili per vet natyren e tij nuk eshte i rinovueshem dhe per kete gje ka nevoje te mbrohet dhe vleresohet per t'i garantuar jetegjatesine.¹¹ Qytetet artistike apo historike jane gjithmone me te privilegjuarat nga pikepamja e vezhguesve dhe ruajtesve te artit dhe kultures. Turizmi kulturor ka si qellim te jap kontributin e tij duke perqendruar veshtrimin ne aspektet ekonomike dhe te punesimit, duke nenvizuar vleren e aktiviteteve kulturore dhe kontributin e saj ne nderthurjen dhe mbarevajtjen e raporteve sociale.



6.1.4. Ekoturizmi

Ekoturizmi eshte menyre e udhetimit modern te turisteve me qellim te mbeshtetjes dhe ruajtjes se mjedisit natyror dhe te trashegimise kulturore ne bashkepunim me komunitetin lokal. Eshte udhëtim shoqëror ambiental qe tërheq vëmendje për te pare dhe ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe thesareve arkeologjik.



¹¹Čordaš Mihajla Ljubomir: Kulturne karakteristike odmora u radnom i slobodnom vremenu i njegov uticaj na način života ljudi, fq.97-104.

6.1.5. Turizmi rural

Eshte nje prej formave dhe faktoreve te rendesishem ne aktivizimin dhe zhvillimin e qendrueshem te zonave rurale e cila ndihmon ne ruajtjen e tradites, identitetit, zakoneve, mjedisit, si dhe forcimin tradicional, ekologjik te prodhimit vendas i cili ndihmon zhvillimin e zonave rurale ne kontekstin e zhvillimit te qendrueshem. Turizmi rural eshte qendrimi i turisteve ne nje ekonomi shtepiake (amviseri) e cila eshte e organizuar si ekonomi turistike rurale per pushim dhe rekreacion. Sherbimet turistike ne turizmin rural jane: Mbledhja e frutave, vjelja e pemeve dhe perimeve, mbledhja e te lashtave, dhenia me qera e kuajve per kalerim dhe sherbimet tjera ne ekonomine shtepiake ne fshat. Ne ekonomine shtepiake ne fshat mund te pergaditen dhe te sherbehen ushqimet e ngrohta dhe te ftohta, lengje te cilat jane kryesisht prodhime vendore.



6.1.6. Turizmi nautik

Eshte forme e vecante e turizmit e cila karakterizohet me levizjen e anijeve turistike ne det, liqene apo lumenje duke perfshire qendrimin e tyre ne portet bregdetare po ashtu dhe perfshire te gjitha infrastrukturen e cila gjendet ne porte ne sherbim te turisteve.¹²



¹²Čordaš Mihajla Ljubomir: Kulturne karakteristike odmora u radnom i slobodnom vremenu i njegov uticaj na način života ljudi, fq 128-134.

6.1.7. Turizmi kongresial

Konsiderohet nje teresi sherbimesh turistike e cila ka te beje me organizimin e tubimeve shkencore, politike, profesionale, kulturore-sportive dhe te takimeve te tjera.



6.1.8. Turizmi i gjetise dhe peshkimit

Konsiderohet organizimi dhe realizimi i qendrimit te gjetareve-turiste, pranimi dhe vendosja e tyre, ndermjetesimi ne organizimin e gjetise si dhe sherbimet tjera lidhur me qendrimin e gjetareve-turiste. Po ashtu edhe turizmi i peshkimit paraqet formen e rekreacionit e cila po merr permasa gjithnje e me te medha¹³.



¹³Čordaš Mihajla Ljubomir: Kulturne karakteristike odmora u radnom i slobodnom vremenu i njegov uticaj na način života ljudi, fq.139-142.

6.1.9. Turizmi rinor

Eshte qendrimi i turisteve te rinj[ne hotelet-hostelet per te rinje ose ne objektet e parachikuara per te rinje (kampet, shtepite per te rinje) me qellim te organizimit te programeve kulturore, zbavitese, sportive, arsimore dhe rekreative per te rinjte.



6.1.10. Turizmi shendetsor

Eshte dege e vecante e turizmit e cila per nga ana profesionale ka per qellim natyren sheruese dhe perdor procedurat e terapise fizike me qellim te permiresimit te shendetit dhe permiresimit te cilesise se jetes se vizitoreve. ¹⁴Turizmi shendetesor shfrytezon faktoret natyrore medicinale te cilat mund te jene: deti, banjat sheruese dhe vendet klimatike.



¹⁴<http://www.recreation.ucr.edu/>

6.1.11. Turizmi fetar

Eshte nje forme e turizmit ku njerezit te cilet besojne, udhetojne individualisht ose ne grupe drejte vendeve te shenjta qe i perkasin religjioneve te ndryshme sic eshte rasti per turizmin me masiv fetar ne Haxh (Meke) ne Arabine Saudite.



6.1.12. Turizmi dimeror

Per shume vende eshte burim i madh i te ardhurave ku rolin kryesor kane sportet dimerore, sic eshte skijimi i cili zhvillohet ne shpatet e mbuluara me bore. ¹⁵Kjo forme e turizmit eshte ne trend te zhvillimit infrastrukturor.



¹⁵<http://www.recreation.ucr.edu/>

6.2. BENEFICIONET E TURIZMIT**6.2.1. Disa Perparesi te Turizmit**

- Ofron mundësitë e punësimit
- Gjeneron shkëmbime te huaja
- Rrite te hyrat
- Rrite GNP-ne
- Zhvillimi i infrastrukturës se turizmit ndihmon stimulimin e industrisë dhe tregtisë vendore
- Justifikon mbrojtjen dhe përmirësimin ambiental
- Rrite te hyrat qeveritare
- Ndryshon ekonominë
- Krijon imazh te favorshëm për destinacionin
- Lehtëson procesin e modernizimit
- Ofron rekreacion për turistet dhe lehtësime për popullatën lokale
- Ofron për te huajt mundësi te favorshme impresive nga regjionet apo vendet e vogla

6.2.2. Beneficionet e Turizmit – Ekonomike – Ofron mundësi te punësimit gjenerimin e përvojave te huaja, i rrite te hyrat, Rrite GNP, munde te ndërtohet mbi infrastrukturën ekzistuese ,zhvillon një infrastrukturë qe po ashtu do te ndihmoje stimulimin e tregtisë vendore dhe industrisë , shpërndanë zhvillimin dhe rrite te ardhurat e qeverise

6.2.3. Beneficionet e Turizmit - Sociale - Zgjeron horizontet arsimore dhe kulturore,përmirëson kualitetin e jetës – te ardhura me te larta dhe standard te përmirësuar te jetesës ,arsyeton mbrojtjen dhe përmirësimin ambiental,ju ofron turisteve lehtësime rekreacionale qe munde te përdoren nga popullata vendore

6.2.4. Beneficionet e Turizmit – Kulturore - Forcon ruajtjen e trashëgimisë dhe traditës ,Interes te vizitoreve ne kulturën vendore, ofron punësim për artistet, muzicientet dhe artistet e tjerë performues qe e shtojnë trashëgiminë kulturore thyen barrierat e gjuhës, barrierat social-kulturore, barrierat e klases, barrierat raciale, politike dhe barrierat religjioze .Krijon një imazh te favorshëm *gjithë-boteror* për një destinacion, promovon një komunitet global ,promovon paqe dhe te kuptuarit ndërkombëtar

6.2.5. Beneficionet dhe Rendesia e Ekoturizmit - Ofron pune dhe te hyra për njerëzit lokal Krijon fonde te mundshme për blerje dhe përmirëson vendet e mbrojtura për te tërhequr me shume ekoturist ne te ardhmen.Ofron edukim ambiental për vizitoret Inkurajon ruajtjen e trashëgimisë dhe ambientit .

6.3. DISAVANTAZHET E TURIZMIT

6.3.1. Disa Disavantazhe të Turizmit

1. Zhvillon tejkalime te kërkesës
2. Krijon humbjet e mëdha qe benefitet ekonomike nuk shtohen
3. Devijon fondet për forma me premtuese te zhvillimit ekonomik
4. Krijon probleme sociale nga te hyrat e ndryshme, diferencimet sociale, futja ne përdorim prostitucionit, lojërave te rrezikshme, krimet, dhe kështu me radhe
5. Degradon ambientin fizik te natyrës
6. Degradon ambientin kulturor
7. Pozicionon veshtiresit sezonale
8. Rrite cenueshmerine për ndryshimet politike dhe ekonomike
9. Shton inflacion ne vlerat e tokës dhe çmimit te mallrave dhe shërbimeve lokale

6.3.2. Disavantazhet e Turizmit - Ekonomike -Zhvillon kërkesën e tejkalimit ,rezulton ne përhapjen e larte,krijon vështirësi te sezoneve ,shkakton inflacion,munde te rezultojë ne zhvillim te pabalancuar ekonomik dhe rrite cenueshmerin per ndryshimet ekonomike dhe politike


6.3.3. Disavantazhet e Turizmit – Sociale -Krijon probleme sociale ,degradon ambientin natyror dhe kulturor dhe krijon ndotje.Kërcënon strukturën e familjes,komercializon kulturën, religjionin dhe artet ,krijon keqkuptime,krijon konflikte ne shoqërin mikpritëse dhe kontribuon ne sëmundjet, lëkundjet ekonomike dhe problemet e transportit

6.4. LLOJET E KOMUNIKACIONIT NE TURIZEM

6.4.1. Komunikacioni Ajror - industria boterore ajrore barte mbi 1 bilion pasagjere ne vite. Kjo industri ka rendesi te madhe per zhvillimin e turizmit nderkombetar pasi qe lidh vendet dhe zonat e ndryshme ne distanca te medha per kohe me te shkurter. Komunikacioni ajror ze vend te rendesishem ne ekonomine turistike dhe ekonomin e pergjithshme boterore. Permes ketij lloj komunikacioni jane realizuar miliona fluturime turistike dhe me miliona njerz kane vizituar vende te ndryshme te botes. Vlen te theksohet se nga qindra miliona dollare nga benifitet e ketij lloj transporti , 40% jane perdorur per qellime turistike. Rol me rendesi ne ngritjen e cilesise dhe zhvillimin e komunikacionit ajror kane dy organizatat te cilat rregullojne kete forme te transportit nderkombetare ajror: ICAO - International Civil Aviation Organization si dhe IATA – International Air Transport Association.




6.4.2. Komunikacioni Hekurudhor -eshte dega me e vjeter e transportit e cila ka ndikuar ne qarkullimin e turisteve ne menyre masovike. Ka arritur piken vellimore ne SHBA ne vitin 1920.Hekurudhat e medha deshirojne jashte sherbimit te pasagjerit (perveç shërbimeve te periferisë). Shërbimi i pasagjereve varet ne amtrak. Gjendja është e njëjtë ne Kanada me shërbimin e pasagjereve te varur ne shërbimin përmes hekurudhave.Shërbimi hekurudhor i pasagjereve është me shumë i rendesishem jasht Amerikës Veriore. Ky lloj transporti eshte zhvilluar deri ne fillim te shekullit XX kur ka filluar te marr hov komunikacioni rrugor dhe ai ajror.Trena te shpejtësive te medha ofrojnë një alternative te udhëtimit.



6.4.3. Komunikacioni Automobilistik-Eshte mënyra me e popullarizuar e udhëtimit ne bote për arsye te gjendjes, fleksibilitetit dhe pershtateshmerise. Eshte forme e preferuar e turisteve qe nga fillimi i shekullit XX e vazhdon deri ne ditet e sotme. Rritja e standardit jetesor ka krijuar baze per zhvillimin e kesaj forme te turizmit. Zhvillimi i kesaj forme te komunikacionit eshte i lidhur me futjen ne funksion te automobilit te pare ne vitin 1891 ne France. Prej kesaj kohe evolucioni i zhvillimit te automobilit ka lulezuar me shpikjen e motorit me djegie te brendshme-benzines. Ne zhvillimin e komunikacionit automobilistik kane ndrikuar modernizimi i rrugeve te karakterit te ndryshem si dhe modernizimi i industris automobilistike.



6.4.4. Komunikacioni i Lundrimit –pjesa me e madhe e rruzullit tokesor eshte e perbere nga siperfaqet e medha ujore andaj vend te rendesishem zene transportimi i mallrave dhe udhetareve permes komunikacionit ujqor me qellime turistike. Mjetet e transportit ujqor jane mjaft te pershtatshme per udhëtimet turistike pasi qe plotesohen te gjitha nevojat e domosdoshme per ushqim,fjetje,rekreacion dhe programe te ndryshme kulturo-artistike. Ka nje segmenti te rritjes me te shpejt ne industrinë e udhëtimit,qe nga viti 1980 kishte një rritje mesatare vjetore prej 8.4%.



Bota e Turizmit ne vitin 2020

Parashikimet e Mberritjeve te Turisteve Nderkombetar (million) ne tere boten dhe me Regjion 1995-2020

Regjione	Arritjet e Turisteve (million)			
	1995	2000	2010	2020
Evrope	335	390	527	717
Azia Lindore/Paqesori	80	116	231	438
Amerika	111	134	195	284
Afrika	20	27	46	75
Lindja e Mesme	14	19	37	69
Azia Jugore	4	6	11	19
Botë	564	692	1.047	1.602



Forcat që Ndikojnë në Turizëm në te Ardhmen¹⁶

- Ekonomike
- Politike
- Vetëdijesimet socio-ambientale
- Teknologjia
- Ndërrimet demografike
- Ndryshimi i sistemeve te vleres
- Diversiteti brenda botes homogjene
- Kërkesa për stabilitet dhe siguri
- Presionet për migrim masiv
- Ndryshimi nga një shërbim te një ekonomie me përvojë
- Evolucioni i kohës se lire
- Konkurrenca për kohe te lire

¹⁶<http://www.recreation.ucr.edu/>

7. PËRFUNDIMI

Rekreacioni si nevojë njerëzore paraqitet së bashku me lindjen e shoqërisë. Në kushtet e sotme rekreacioni paraqet aktivitetin e gjithanshëm të njeriut jashtë punës profesionale, të cilin ai e zgjedh vetë e që i kontribuon përparimit dhe zhvillimit të krijimtarisë dhe personalitetit të tërësishëm të tij. Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, zhvillohet edhe rekreacioni si lëmë i posaçëm në sistemin e kulturës fizike. Qysh në bashkësinë e parë njerëzore, njeriu ka vallëzuar, është ushqyer, i është lutur idhujve, ka vizatuar, etj dhe këto aktivitete të asaj kohe mund të konsiderohen si rekreacion.

Njeriu jeton në kohën e cila është e thjeshtë, por ai këtë kohë e shfrytëzon në forma të ndryshme të shfaqjes së jetës së tij dhe krijimtarisë së tij si qenie njerëzore. Në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës, kohën prej njëzet e katër orëve mund ta ndajmë në kohën në punë dhe në kohën që mbetet jashtë punës. Koha e punës plotësohet me veprimtari në procesin e prodhimit, në krijimin e të mirave materiale dhe sigurimin e ekzistencës. Koha jashtë punës është ajo kohë gjatë të cilës njeriu nuk punon në prodhim dhe kryen aktivitete që nuk kanë lidhje me sigurimin e ekzistencës së tij.

Koha që i mbetet njeriut jashtë punës, nuk do me thënë që ai mund ta shfrytëzojë në mënyrë të lirë andaj edhe kjo nuk mund të identifikohet me kohën e lirë. Në kohën jashtë punës njeriu i duhet të kryejë veprime të caktuara me qëllim të ekzistencës së tij, pa marrë parasysh dëshirën e tij. Vetëm një pjesë e kësaj kohe jashtë punës, njeriu mund ta shfrytëzojë në plotësimin e kërkesave të tij fizike dhe psikike pa ndonjë imponim me qëllim të plotësimit të kënaqësisë së tij.

Puna e përcjell njeriun që nga fillimi i jetës së tij shoqërore. Që njeriu të mund të kryejë çfarë do lloj pune është e nevojshme aftësi e caktuar e organizmit, e cila shpreh format e ekuilibrit të brendshëm të funksioneve fiziologjike sa më saktë që është e mundur në raport me gjendjen e organizmit në gjendje të pushimit dhe që pas punës përsëri dhe shpejt të arrijë të gjitha format e baraspeshës të cilat kanë qenë të prishur, mund të definohet si esenca e aftësisë biologjike të njeriut për punë. Duke u nisur nga ky fakt atëherë është e kuptueshme pse përpiqemi që sa më racionalisht t'i shfrytëzojmë kapacitetet e organizmit të punëtorit si funksione të paradispozitive të tij fizike, fiziologjike dhe psikologjike. Pra, mund të thuhet se aftësia punuese e njeriut nënkupton një sërë aftësish funksionale, të cilat janë të lidhura me organe të tij të caktuara dhe ruajtjen e mekanizmave kompenzues të tij.

Karakteristika e punës dhe kapaciteti funksional i organizmit të njeriut gjithnjë gjenden në raport të ndërsjellë. Ai raport është më i përshtatshmi atëherë kur njeriu si tërësi biologjike i përshtatet faktorëve të rrethit “profesional” dhe anasjelltas.

Dikur puna fizike në prodhim të drejtpërdrejtë ka pasur primatin, kurse sot ka gjithnjë e më pak tendosje fizike, e më shumë kërkohet shpejtësi dhe precizitet në punë, koncentrim i madh, vëmendje dhe angazhim i gjithanshëm i njeriut që të mund ti përgjigjet kërkesave, të cilat i shtron revolucioni teknologjik shkencor.

Hulumtime të shumta të ne dhe në botë, tregojnë për rëndësinë e organizimit shkencor të punës dhe pushimit. Në këtë kuptim edhe shtrohen kërkesat e zhvillimit të rekreacionit, si faktor i rëndësishëm i humanizimit të punës, ruajtjes dhe përparimit të shëndetit, rritjes së aftësisë punuese dhe produktivitetit.

Në kushtet bashkëkohore, revolucioni shkencor-teknologjik ndikon fuqishëm në personalitetin e njeriut, si forca themelore prodhuese në shoqëri. Ai e ndryshon përmbajtjen e jetës, formon nevojat e njeriut dhe të shoqërisë, i ndryshon kontaktet ndërmjet njerëzve dhe përmbajtjen e kohës së lirë të tyre. Zhvillimi i rekreacionit merr rëndësi të posaçme duke e ndikuar edhe në vetë zhvillimin e prodhimit.

Që të mund të mbahet baraspesha fiziologjike e funksioneve, është e nevojshme aftësia fizike, të cilën duhet ta ketë njeriu si qenie biologjike. Pra, është e nevojshme që njeriu, si qenie biologjike ti ruajë organet e tij vitale, si dhe një sërë mekanizmash kompenzues fiziologjik, për ta siguruar baraspeshën e domosdoshme fiziologjike të organizmit. Faktorë të rëndësishëm që drejtpërsëdrejti ndikojnë në aftësinë e ruajtjes së baraspeshës së kapaciteteve funksionale pasqyrohen në: efikasitetin dhe aftësinë e masës muskulore, efikasitetin dhe aftësinë e sistemit respirator dhe kardiovaskular, aftësinë dhe ruajtjen e organeve sensorike, gjendjen psikike, shkallën e paraqitjes së lodhjes dhe shpejtësinë e ripërtëritjes së organizmit pas punës. Mundësitë e kapaciteteve funksionale të organizmit të njeriut dhe karakterit të punës janë gjithnjë në lidhmëri të ndërsjellë. Një raport i tillë, sot konsiderohet si më i pranueshmi nëse njeriu, si qenie biologjike përshtatet me kërkesat e punës profesionale. Këtu, para së gjithash, mendohet në karakteristikat themelore të procesit teknologjik, në kërkesa të ndryshme të vendit të punës, në kushte mikroklimatike, në dëmtimet profesionale etj.

Niveli i prodhimit dhe ekonomizimi i punës nuk varen ekskluzivisht nga teknika e punës, kushteve të jashtme, llojit të punës, vendit të punës etj. Rol shumë të rëndësishëm në sistemin njeriu-makina-puna ka vetë njeriu, sepse pikërisht prej tij pritet kryerja e detyrave të punës. Suksesi në punë varet nga shumë faktorë, por para së gjithash nga raporti i punëtorit ndaj punës, d.m.th. nga aftësia e tij profesionale dhe punuese.

Aftësia punuese varet nga lloji dhe niveli i lodhjes së punëtorit. Ai rritet me kohën e punës. Sa më gjatë të punojë punëtori, varësisht nga ritmi i punës dhe karakteri i punës, aq më i dobët është rezultati i tij në punë në njësinë e kohës. Me kohën e punës nuk rritet vetëm lodhja, por rritet edhe shkalla e përpjekjeve subjektive, si shkaktar fiziologjik i lodhjes.

Duke u nisur nga supozimi se lëvizja e kulturës fizike përmes formave të saj të ndryshme, përmbajtjet dhe metodat e punës, duhet të bazohet në themele të qarta, do të tregojmë në disa obligime dhe përgjegjësinë shoqërore të bartësve dhe organizatorëve të kësaj veprimtarie, të cilën ata duhet ta bartin mbi vete në ndërmarrje. Në kushtet e reja shoqëro-ekonomike, rekreacioni nuk paraqet vetëm veprimtari argëtuese dhe për pasurimin e shfrytëzimit të kohës së lirë. Ai, njëkohësisht paraqet një kategori të rëndësishme ekonomike. Me ndikimin e tij pozitiv në shëndet, ngritjen e aftësisë fizike dhe punuese të njerëzve punues në ndërmarrje, i kontribuon dhe krijon mundësi për produktivitet më të lartë të punës. Organizatat punuese, në pajtim edhe me parimet kushtetuese për krijimin e kushteve dhe përparimin e veprimtarisë punuese, secila ndërmarrje duhet të plotësojë detyra të caktuara nëse dëshirojnë të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Është e domosdoshme që në ndërmarrje në ditët e sotme të zhvillimit shoqëror në aktet e tyre të vërtetohet vendi, roli dhe rëndësia si dhe detyrat konkrete të rekreacionit me të gjitha specifikat e punës në organizatën punuese. Shpesh ndodh që disa çështje vitale për shoqërinë i pranojmë vetëm deklarativisht, por obligimet e marra realizohen shumë pak ose aspak.

Mirëpo, problemi i rekreacionit në ndërmarrje nuk është i lidhur vetëm me obligim statuar, ku shumica e organizatave vetëm formalisht i plotësojnë kërkesat ligjore, duke futur në statutet e tyre vetëm parimet dhe formulimet e përgjithshme pa ndonjë orientim më të saktë të kësaj veprimtarie. Një qasje e tillë dhe qëndrim në praktikë ndaj rekreacionit në ndërmarrje bart me vete një numër të madh të mangësive dhe shpreh një prani të konzervativizmit, i cili është i shprehur gati në të gjithë lëmenjtë e kulturës fizike.

Paraqitja e rekreacionit ka rrjedh si pasoj e zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë. Procesi i pësosur teknologjik ka ndikuar me të madhe në karakterin e punës, kushteve të punës, mjedisit punues dhe mënyrës së jetesës.

Ndryshimet në karakterin e punës, llojin dhe intenzitetin e ngarkesave gjatë punës, janë të kushtezuara para së gjithash me aplikimin e procesit bashkohor teknologjik, automatizimit dhe kibernetizimit të prodhimitarisë.

Në këto kushte të punës vie deri te zvoglimi i dukshëm i aktivitetit trupor. Në kushte të punës bashkëkohore dita ditës bie shkalla e aktiviteteve punuese të cilat kryhen me ndihmën e ngarkesave mesatare apo maksimale muskulore, por çdo ditë e më shumë vijnë në shprehje lëvizjet të cilat përseriten me tempo të shpejtë dhe kërkojnë nivel të lartë të shpejtësisë, precizitetit dhe koncentrimit.

Aktiviteti punues, sot me të madhe realizohet në pozitë të ulur apo edhe në pozitë statike (në këmbë) çka nënkupton ngarkesa të mëdha statike të grupeve të mëdha të muskujve. Kjo vështirëson qarkullimin e gjakut dhe shkakton dhimbje të duarve, krahëve dhe të këmbëve.

Duke pas parasysh gjitha këto fakte që u përmendën dhe ambientin që na rrethon të shkatëruar në masë të madhe (ajëri i papastër, prezenca e kemikalieve, zhurma) mund të themi se rekreacioni është produkt i nevojës së shoqërisë pasi që si pasojë e këtyre kushteve mikroklimatike dhe kësaj tempore të jetesës vie deri te problemet shëndetësore dhe sëmundjet karakteristike të cilat janë të kushtëzuara me industrializim dhe urbanizim.



Të ushtruarit e drejtë dhe me rregull mund të ndikoj pozitivisht në shumë funksione të organizimit të cilat bazohen në veprimin e katër grupeve të karakterisitikave (aftësitë funksionale, aftësitë motorike, aftësitë morfologjike dhe karakteristikat psikosociale) të cilat në mënyrë të barabartë ndikojnë në shëndet.

Si pasojë e moslëvizshmërisë dhe plakjes pason dobësimi i organizimit, rezistenca dhe aftësia e tij i përshtatet kushteve të jetës dhe të punës, prandaj në këtë mënyrë keqësohet gjendja shëndetësore.

Duke pas parasysh gjitha këto të dhëna dhe ambientin e shkatëruar dhe të ndotur në masë të madhe (ajëri i papastër, prezenca e kemikalieve, zhurma) mund të themi se rekreacioni është produkt i nevojës së shoqërisë pasi që si pasojë e moslëvizshmërisë vie deri te problemet shëndetësore dhe sëmundjet të cilat janë të kushtëzuara mënyra bashkohore e jetesës.

Për t'ia arrit cakun e realizimit të projekteve të shumta kërkohet edhe një financim i donatorëve të shteteve të cilat kanë një traditë dhe kulturë turistike.

8. ABSTRACT

Recreation as a human need is presented along with the society. In today's condition represents general human activity out of the professional work which he choose himself contributing to the progress and development of creativity and his overall personality. With the development of human society, recreation is developed as special subject in the system of physical culture. Since the first human community, man has danced, is fed, prayed, has drawn, etc., and these activities can be considered as recreation.

Men live in time which is simple but this time he uses in different ways of appearance of his life and his creativity as human beings. In the most general sense of the word, the time of twenty-four hours can be divided into time at work and the time that remains out of work. Working time is filled with activities in the manufacturing process, creation of goods and provision of existence. Time off work is the time during which the person does not work in manufacturing and performs activities that are not related to the provision of its existence.

Time remaining out of work does not mean that he can use freely, therefore this can not be identified with the free time. At the time outside the work man must perform certain actions with the purpose of its existence, regardless of his desire. Only a part of the time out of work man can use on satisfaction of his physical and psychic needs without any imposition in order to meet his satisfaction.

The work follows the man since the beginning of his social life. That a man can perform whatever work, it is necessary for a certain organism skill which expresses the internal equilibrium forms of physiological functions as accurately as possible in relation to the condition of organism able to rest and again after the work as soon as possible reach all forms of balance which have been broken, can be defined as the essence of human biological ability to work. Starting from this fact, it is understandable why we try rationally utilizing organism capacities of employee as his physical, physiological and psychological pre-dispositions functions.

So, we can say that human working ability means a functional set of skills that are related to its specific organs and maintaining its compensatory mechanisms.

Characteristics of work and functional capacity of man organism always can be found in mutual relation. This relation is more appropriate when a man as a whole biological fits to the factors "professional" and vice versa.

Once the physical work in direct production has had primacy, while today there are more and less physical exertion, speed and precession is required more at work, great concentration, attention and commitment of man who could answer the requests which raises the scientific technological revolution.

Extensive research of us and in the world, indicate the importance of the scientific organization of work and rest. In this respect, requirements on recreational development raised as important factors of work, maintaining and improving health, increasing work ability and productivity.

In contemporary terms, scientific-technological revolution strongly affects human personality as the basic production force in the society. He changes the content of life, forms the needs of man and society, changing contacts between people and the content of their free time. Development of recreation takes special importance to the impact on the development of production itself.

That balance can be maintained physiological functions, physical ability is required, which the man should have as biological beings. So, it is necessary that man as biological being maintain his vital organs, as well as a variety of compensatory mechanisms to ensure the necessary physiological balance of the body. Important factors that directly affect the ability of keeping the balance in functional capacity, efficiency and ability of muscle mass, efficiency and capacity of the respiratory and cardiovascular system, mental condition, tiredness appearance and speed of recovery of the body after work. Possibilities of functional capacities of the man organism and the character of the work are always in mutual relation. Such a report nowadays is considered more acceptable if the man as biological being fits with the requirements of professional work. First of all, here is thought on basic characteristics of the technological process, different requirements of the work place, microclimatic conditions, professionally, etc.

9. LITERATURA

1. Reljac, Mirko&Bartoluci, M.: Turizam i Sportska Rekreacija, Zagreb, 1987.
1. Kerić Borka Mara: Efekti programiranog vežbanja na produktivnost rada
2. Kostić Krenislava Miroslav: Uticaj radno-ergonomskog statusa na motivaciju bavljenja sportsko-rekreativnim aktivnostima
3. Čordaš Mihajla Ljubomir: Kulturne karakteristike odmora u radnom i slobodnom vremenu i njegov uticaj na način života ljudi
4. Turjaka Bujar: Ligjerata te autorizuar per Master, Prishtine 2008
5. GRUP AUTORESH”SPORTSKA KINEZIOLOSHKA REKREACIA”
6. Mithad Blagejac “TEORIA SPORTSKE REKREACIJE”Novi Sad 1994
7. www.escun.edu Leisure and recreacion
8. <http://sl.wikipedia.org/wiki/Kategoria:Rekreacija>
9. <http://www.recreation.ucr.edu/>